

Lajmëtar

ORGAN I KOMITETIT TË PARTISË TË RRËTHIT TEPELINË

VITI I 4-t / Nr. 12 (160) | E martë, 19 mars 1991 | Çmimi 20 qindarka

BESIM PER FITORE

- Nga mbledhja e byrosë së Komitetit të Partisë të rrëthit -

Dhe pak ditë na ndajnë nga 31 Marsi, dita kur mbarrë populli ynë do të vendosë nëse do të qëndrojë në pushtet PPSH apo ndonjë nga partitë e tjera opozitare. Për herë të parë gjatë këtyre 45 vjetëve populli vihet para një alternative të tillë. Komiteti i Partisë së rrëthit dhe gjithë Partia e Punës në rrëth, kanë besim të plotë që klasa punëtore e Tepelenës, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia e saj, si kurdoherë, dhe në këto zgjedhje, votën e tyre do ta japin për kandidatët e Partisë së Punës, do ta japin për pushtetin e popullit, që me aq gjak e sakrificë u fitua, që me aq gjakë e djersë u mbajtë në këmbë për gati gjysëm shekulli me radhë. Por rruga drejt kësaj fitore nuk është një fushë me lule por një rrugë e vështirë, që kërkon punë, kërkim durim, kërkim guxim e mençuri, nga çdo komunist e organizatë partie, nga çdo patriot e qytetar i ndershëm. Nga secili prej tyre duhet të jetë e qartë se sot më shumë se asnjëherë tjetër kërkohet patriotizëm e militantizëm i flakët. Këtë nuk e dikton thjesht situata politike pluraliste në vendin tonë por dhe shumë

faktorë të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm, që nga veprimtaria agjenturore e gjer të mllfet e eksekt e ndryshme, me mungësën e edukatës pluraliste, me një varg ngjarjesh që rrjedhin kundër logjikës dhe interesave të popullit, në të cilat shpesh implikohen dhe kuadro, komunistë e të zgjedhur të veçantë në organet e pushtetit.

Prandaj këto ditë që mbeten, duhet të shfrytëzohen nga secili në maksimum për fitoren e madhe, duke larguar nga vetja çdo hezitim, çdo shenjë pritmërie, çdo hutim e plogështi. «Bilanci» i 31 Marsit bëhet që tani duke e njohur dhe zotëruar gjëndjen në çdo fshat e lagje qyteti, në çdo familje e për çdo individ.

Kjo periudhë është kohë sulmi për gjithë komunistët e organizatat - bazë të Partisë, për çdo veprimtar e përkrahës të programit të PPSH. Të gjithë duhet të intensifikojmë punën për t'u njohur më mirë nga masat programi i PPSH, duke punuar kokë më kokë me nërëzit, të punojmë për t'i sqaruar e bindur njëzëit ose është i domosdoshëm të fitojnë kandidatët e PPSH. Edhe kuadrot e ekonomisë e të pushtetit, kudo ku ja-

në si dhe të sektorëve të tjerë social - kulturorë, që dëshirojnë fitoren e Partisë duhet të merren më shumë se asnjëherë tjetër me zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë popullin për të lehtësuar sado pak angazhimin e saj tani në këtë drejtim. Duhet hequr përfundimisht nga mendja koncepti dhe praktika e dëmshme «hë se kemi kohë». Përkundrazi jemi shumë të vonuar në kohë, të cilën kërkohet ta kompesojmë me dyfishimin e trefishimin e punës dhe e energjive.

Në shërbim të këtij objekti të madh, fitores në zgjedhjet e 31 Marsit, le të vëmë vendosmërinë tonë dhe besimin e patundur të Partia e Punës me shokun Ramiz Alia në krye, besimin tek programi i saj, përvojën e gjatë dhe të pasur që kemi në organizimin dhe zhvillimin e fushatave elektorale, lidhjet e ngushta të Partisë me masat, tek të cilat duhet të kemi besim të plotë se ata siç e kanë dashur, e duan e do ta duan përherë Partinë e Punës. Partinë që e themeloi dhe e udhëhoqi nga njera fitore tek tjetra me guxim e largpamësi i paharruari Enver Hoxha.

Masa të plota

Punët e ditës në bujqësi janë të shumta. Kooperativistët e Qesaratit po i përballojnë ato me masa të plota tekniko - organizative. Gjendja e grurit paraqitet e mbarë, kohët e fundit po intensifikohen shërbimet dhe po bëhet kujdes për mbrojtjen nga dëmtimet. Edhe gjendja e farishteve të perimeve e duhanit paraqiten të mbara. Është siguruar bimë për 12 ha, trapalantimi i të cilit ka filluar. Edhe pjesëmarrja e forcave në punë është e kënaqëshme dhe mungesat po eliminohen.

Në foto: Çast nga shërbimet në farishte.



Foto: H. BRUZH

GJATE JAVES

U mblodh Këshilli Popullor i Rrethit

Më datën 13 mars 1991 u zhvillua mbledhja e Këshillit Popullor të rrëthit në të cilën, krahas anëtarëve të tij ishin të ftuar dretjues të organeve të pushtetit dhe ekonomive të fshatrave si dhe dy qyteteve të rrëthit. Raportin «Mbi punën e bërë nga Këshilli Popullor i rrëthit për të përballuar situatat aktuale që po shqetësojnë në rrëth» e mbajti kryetari i Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrëthit Gjergji Velo. Si në raport dhe në diskutimet u shpreh me forcë të madhe shqetësimi mbarë shoqërorë për disa veprimime të nxitura që po kryehen në disa kooperativa bujqësore të rrëthit, të cilat

cënojnë rëndë sistemin e ekonomisë së kolektivizuar. Në mënyrë të veçantë për të tilla veprime u kritikuan dhe u vunë para përgjegjësisë të zgjedhurit në organet e pushtetit dhe kuadrot e ekonomisë të kooperativës së Krahesit, ata të kooperativës së Dhëmbanit për gjëndjen e Lab Martallozit, dhe të Turanit për Bençën.

Këshilli Popullor i rrëthit vuri detyrë komitetit Ekzekutiv të KP rrëthit, organeve të pushtetit dhe të ekonomisë si dhe organeve të drejtësisë për të stabilizuar gjëndjen në këto kooperativa konformë statutit të tyre dhe ligjeve të shtetit, brenda datës 20 mars.

Aktiv për zbërthimin e programit elektorale të PPSH-së

Më datën 12 mars në një nga sallat e shtëpisë së kulturës «M. Matohiti» në qytetin e Tepelenës, komiteti i Partisë së Punës së rrëthit, organizoi një aktiv për zbërthimin e programit elektorale të PPSH. Mërmih pjesë anëtarë të plenumit, sekretarë të organeve - bazë, drejtues të sferës prodhuese në ekonomitë shtetërore e kooperativiste, specialistë të fushave të ndryshme nga i gjithë rrëthi etj. Mbledhjen e hapi sekretari i komitetit të Partisë së Punës, Muhamet Hada i cili theksoi rëndësinë e këtij akti dhe detyrat që u dalin organeve - bazë e tërë komunistëve të rrëthit tonë për periudhën deri në 31 mars.

Punonjësit e aparatit të KQ të PPSH, Dhimitër Shandro e Koço Broka, që bënë zbërthimin e programit, e vunë theksin në atë se ky program mbështetet në punën dhe militantizmin e gjithë anëtarëve të Partisë së Punës, e në rinovimin e vetvetes në radhë të parë. Rrënjët e tij janë në popull, sepse ai si edhe më parë, ka qenë mbështetje kryesore e programeve të saj dhe përherë në krah të komunistëve me vepra ka shprehur dashuri e besim.

këri për Partinë, Demokracizimi i mëtejshëm i saj e tërë vendit, hap horizontet të reja. Ai ka në bazë punën e gjithanshme të çdo anëtarë në frontet e punës kudo që janë të cilët me formë e metoda të reja do të gjejnë rrugë të pashkelura ku do të ecet me hapa të matura.

Një vend të veçantë zuri zbërthimi i programit ekonomik të PPSH. U theksua se e ardhmja e shoqërisë demokratike ka në themel progresin që nuk mohan realitetin e arritjet pozitive të deritanishme. Qëllimi është që të rrisht mirëqenia e masave punonjëse ku secili do të shpërblehet sipas kontributit dhe punës që bën. Partia e Punës nuk është për privatizimin e fshatit dhe as për shpëtimin e tokës, por për gjerjen e rrugëve të reja në punën e përbashkët ku të prodhohet e fitohet më shumë se deri sot.

Në fund nga të pranishmit u bënë mjaft pyetje të cilat u qartësuan nga dy lektorët. Aktivitë përcaktoi një sërë detyrash që u dalin gjithë komunistëve e organeve - bazë të Partisë së Punës deri në zgjedhjet e reja.

Korresp. i «Lajmëtar»

SQARIM

Nga shumë qytetarë, redaksisë së gazetës «Lajmëtar» i janë bërë sugjerime dhe i janë shkruar letra për t'u përgjigjur në faqet e saj shkrimit që botoi në gazetën «RD» të datës 13 mars, Selman Hodo. Ne, si redaksi, i falënderojmë të gjithë ata por, duke e njohur personalitetin e ar-

tikull - shkruarit kemi mendimin se nuk është në dënjitetin e organit tonë të merremi me të dhe shkrimin e tij. Le ta gëzojë RD-ja.

Për këtë u kërkojmë bashkëqytetarëve tanë ndjesë.

REDAKSIA E GAZETES

Ku e ka zyrën deputeti

Natyrishë që nuk ka asgjë të keqe që deputeti të ketë vendbanimin ose qëndrën e tij të punës brenda zonës së cilës ai i përket. Por ka një problem tjetër që dëshirojmë të shpërjetojmë në këtë shkrim. Deputeti si përfaqësues i popullit në organin më të lartë shtetëror zgjidhet për të shprehur interesat kapitale të vendit, për të dhënë mendime të pjekura për problemet e politikës së brendshme dhe të jashtme, për zhvillimin e ekonomisë dhe kulturës, për problemet e mbrojtjes e plotë probleme të tjera që lidhen me përpunimin e shtetit tonë. Si i tillë ai duhet të jetë jo vetëm njeri me kulturë, njeri që mbi çdo gjë vë interesat e popullit por dhe njeri kurajoz për të debatuar, për të mbrojtur me këmbëngulje dhe argumenta pikëpikëjet e tij apo të programit të Partisë që ai përfaqëson, e jo një të zgjedhur mamur, që di vetëm të ngrejë dorën e të thotë dakort. Deputeti i rrethit të jetë nje-

Nga këto motive duhet të nisesh secili prej nesh kur do të vendosësh kujt prej kandidatëve që janë shënuar në fletën e votimit, nuk do t'i heq vizë. Është një përgjegjësi e madhe ndaj popullit e atdheut.

Si shokë me të njëjtën detyrë takoheshim shpesh, këmbënimim mendime, por dhe përvojë pune me njëritjetrin, siç bënim mes nesh të gjithë sekretarët e oqrove dhe organizatave në mbledhjet apo takimet e tjera të pa organizuara. Dhe vazhdimisht na bëhëjsh të mendjen Gramozit, për pëkurinë e gjykimit të tij në kapjen dhe trajtimin e problemeve, për këmbënguljen dhe vendosmërinë e tij për

Detyrën e sekretarit të

Këto tipare të tij të
morale kanë bërë që
zotë respektin e tepër
ve që e duan dhe e
svojë rrethin e tyre.
në bërë që të shikojnë
Gramozin jo thjesht një
heqës të zot, partie, por
të gjitha, një tepelena
e do me shpirt rrethin
që do popullin e tij dhe
spekton zakonet e tij.
shtë i aftë t'i çojë në
proceset e demokratike
që kanë përfshirë kushtet
Tepelenën.

MUHAMMAD HAN

LUZATI DO TE VOTOJE PER GRAMOZ RUÇIN

Kështu e ka patur gjatë gjithë historisë së tij populli i fshatit tonë: ka qenë gjithmonë i bashkuar, ka ditur të zgjedhë kurdoherë, e sidomos në situatat e ndërlikuar, siç janë ato sot, atë pozicion që u shërbejnë interesave të popullit e të atdheut. Ne sot kemi bindjen se interesat e popullit kërkojnë që votat tua japim kandidatëve të PPSH. Është

Shokun Gramoz e njohim mirë për besnikërinë e tij të patundur në vijën e PPSH, si një tepelenas që është i gatshëm për çdo sakrificë për interesat e rrethit dhe të vendit të tij. Si njëri kurajoz, trim e i pa përkulur para vështirësive,

Bexhet Thanasi, Bashkim Shatrailli, Veli Gaxhi, Beqir Çako, Kasëm Xhima, Isanail Guma, Fato Xhima, Mirise Aliaj, Selver Guma, Hyqmet Bodeci, Feim Qibini, Balfajr Progonati, Novruz Xhani, Pajtim Gaxhi, Behare Guma, Çerciz Dena, Qemal Deggjoni, Isa Këpaci, Qamil Bodeci, Luan Musari, Ali Xhani, Bektaş Koci, Mehmet Çako, etj.

Vota ime është e hap
votoj për PPSH-në

I njoth komunistët se për-
gati 50 vetë kanë shkelur në
rrugë të njohura e të pa-
njohura dhe sa herë që de-
lyrat nuk janë plotësuar ka-
në ditur të dalin hapur e pa
ndrojtje para popullit të tyre
me autokritikë të ndershme
e të ndërgjegjshme. Edhe
në proceset e reja të demo-
kratizimit të vëndit ata se-
rish nisen nga vetia duke

Në këto raste pjekur
saj më bind edhe më
për drejtësinë e saj. Ja
se unë do të votoj për
redaktat e Partisë së

ILMI HASA

Korresp. i. Jambougarit.

DUKE KUJTUAR ATO VITE

- Mbresa të një mësueseje -

Në Tepelenë erdha së pari në tetor të 1950-ës, në Tepelenën me bedenë, me 99 shtëpi, që «s'mund të bëhej njëqind». Më 20 gusht 1951 bashkë me vëllain tim Hakiun na caktuan në shkollën 7 vjeçare të Progonatit malor, me 6 mësues gjithsej. Për 7-vjeçaren ishin 4 arsimtarë dhe 2 për filloren, me klasa kolektive: I, III dhe II, IV. Kujtoj kur shkova për herë të parë atje. Udhë këmbësore na u duk shumë e gjatë, mes pyjesh e malesh. Për rrugë automobilistike as që bëhej fjalë. Këngë tjetër përveç atyre të zogjve dhe të zileve nuk dëgjoje. Kur dolëm në Bënçë, kujtuam se mbërritëm, po ec e ec, mes atyre pyjeve «të pasosur» e malesh të lartë, arritëm në Lekdushin - ballkon, ku Progonati dukej si në pëllëmbë të dorës.

Në Progonat, në hyrje të tij, më bëri përshtypje dërrsila pranë Gurrës së kristaltë, ku gratë lanin përkatat (velënxat) e leshta. Ato ndërprejnë punën e na takuan me përzemërsi, madje na shoqëruan në shtëpitë e tyre, aty pranë në lagjen Haxhiat. Takuam në postë, një zyrë tepër e vogël, një nëpunës me shumë kulturë. Më vonë u njohëm më mirë, me Belul Leskajn (xha Beluli ishte i dashur me të gjithë). Të nesërmen u paraqitëm në shkollëzën e atëhershme,

pranë së cilës qëndronte një zyrë që ishte Lokaliteti me disa nëpunës të pushtetit lokal. Një zyrë poste, një lokalitet dhe një shkollë me pak dhoma - kjo ishte qendra e dikurshme e Progonatit. Aty jetonte e militonte një popull me tradita të larta atdhetare, një popull trim Çdo ditë e tregonte veten bujar me njerëzit e mirë dhe trim (deri në përlëshje me të arratisurit - hije të atyre maleve të paepur).

Shumë gra, sa trime dhe të etura për dije, vinin tre herë në javë në kursin kundër analfabetizmit dhe na luteshin t'u bënim tre orë mësim dhe jo dy sa ishte «norma» mësimore... Disa burrave u pëlqente të rrinin gjatë te Rrepet historikë, aty me sherqet hedhur supave. Kur u njoha mirë me ta ndonjëherë u thosha me shaka atë vjershën e Çajupit «Burrat nën hije...» po s'më zemëroheshin. Në ndonjë rast më mbulonin me sharkun e tyre.

Femrat qysh në të gdhirë shkonin në frontet e punëve gjer në darkë, kur duhesh të vinin në shkollën e mbrëmjes. Banoja në lagjen Kurraj. Qënditesha me fëmijët e nxënësit e mrekullueshëm, me edukatë, të dashur e të respektuar. Fshatarët «ndiqnin» nga afër edhe jetën tonë duke na sjellë dru zjarrri (edhe për klasat), ushqime, miell e gatime të tyre,

bulmet, E habitshme: e ndie nin si detyrë të tyre edhe hapjen e rrugës shkollë - shtëpi nga dëbora që arrinte më se dy metra, se ndryshe, unë, vogëlushja «mësuesja 14 vjeçare, si zor të shkonte te vocërrakët e saj që e prisnin e mund të mbeteshin pa mësim. Unë u rrita bashkë me ta. Sa dëshirë do kisha të mbaja mend të gjithë emrat e nxënësve të mi të Progonatit, po gjithësi më kujtohen mirë disa prej tyre si Martin Cukalla, Izet Culli, Memo Dolla, Shëfik Koka, Kujtim Haxhiu, Bedo Shena e sa camaradë të vegjël. Ku të jenë vallë ata tani «S'më harrohet as Teto Mazika, nëna e Ibrahim Ganit, që i binte ziles - violinë.

Kam shkuar gati në çdo shtëpi. Tani Progonati ka ndryshuar shumë dhe ju me siguri keni shkruar për të. Por le t'ju vlejë këto kujtime të thjeshta për të mos harruar nga jemi nisur. Atë e hijeshoi Partia e Punës. Jemi në prag të zgjedhjeve të 31 marsit e me siguri progonatasit do të votojnë për kandidatin e tyre të zemrës. Komunistët u lidhën fort me popullin.

Faleminderit Progonat i paharruar...!

**NAXHIJE KOVAČI
(MEKZIRA),
pensioniste Burrel**

RESPEKT PER VEPREN E BREZAVE

«Le t'u tregojmë të vegjëlvë me sinjeritet dhe thjeshtësi historinë e së kaluarës sonë të pasur, të vuajtjeve dhe fitoreve tona, të gabimeve dhe të disfatave tona. Le t'u flasim atyre për shpresat tona, për gjithçka që i preokuponte ose i gëzonte stërgjyshërit tanë, për atë që na prekon në sot, ose na e mbush zemrën me kurajë.

Njeriu duhet të respektojë veprën e brezave të kalës ndryshe është e pamundur të sigurohet vazhdimësi kulturore, vazhdimësi e përkrahjeve që bëjnë njeriun të gjetur forma të reja të jetesë, më të lira dhe më cilësore».

MAKSIM GORANOV



Qyteti ynë - parë nga bedenat e kalasë

Anëtar të PPSH-së s'të bënë tesera

MJEKU PRANE FAMILJES

Si të parandalojmë sëmundjet...

Në mbledhjen e fundit të Këshillit Popullor të rrethit pjesëmarrësit u ndalën shumë tek diskutanti Xhenet Sula, i cili e nisi fjalën et duke thënë se nuk i ishte krijuar mundësia të vinte në Tepelenë i ulur në një sedile të autobusit por qëndroi në këmbë.

Keq na vjen që këtij të zgjedhurit në këshillin popullor të rrethit, nuk pati njeri në autobus t'i lironte vendin. Po duam, t'i themi se populli vendin ia liron atij për të cilin ka respekt. Por sikundet për ty Xhenet populli i Lopësit nuk ka respekt. Dhe është i natyreshëm qëndrimi i tij. Siç u tha në mbledhjen e këshillit popullor të rrethit, ti je provokues kryesor i qëndrimeve që mbahen aktualisht në fshatin tënd Lab Martaloz ndaj pronës së përbashkë dhe ndër ngatërrestarët kryesor në ekonominë e Dhemblanit, me gjithëse mban vendin e përgjegjësit të degës së kuadrut, të cilin nuk e meriton. Ti ke vetëm katër klasë

shkollë të mesme, dhe nga sa u pa në mbledhjen e këshillit, ty të mungon jo vetëm kultura intelektuale.

Në mbledhjen e këshillit ti u mburre se je anëtar i PPSH. Duam të të kujtojmë se dokumentin e Partisë që mbanë në xhep tundja ndonjë tjetri dhe jo përfaqësuesve të popullit. Nuk janë komunist ata që duan t'i vënë në kazmë ekonomisë kolektive por ata që luftojnë për forcimin e saj. Komunistet nuk e fusin popullin në qorr sokak, tani në prag të zgjedhjeve, siç po e fut ti fshatin tëndë.

Me këtë rast duam t'i themi organizatës - bazë të Partisë ku ti bën pjesë - Mirë që Xheneti mori rrugën e «xhenetit» po ju ç'bëni? Pse po bëni shër. Është detyra e juaj që ta ndihmoni të shikojë veten se ku po e shpie mushka. I thoni të paktën ta dijë se komunist nuk të bën tesera që ke në xhep por lufta për idealin dhe programin e saj.

Korresp. i «Lajmëtarit»

Në këtë periudhë me ndryshime të vazhdueshme të temperaturës së mjedisit, lind nevojja për të hedhur një vështrim edhe nga otorinolaringologjia (ORL), që janë sëmundjet e veshit, grykës, hundës. Këto organe duke u nisur nga veçoritë e tyre e të të gjithë organizmit në tërësi, duhet të kujtojmë se marrin udhë shumë sëmundje në sisteme të rëndësishme të organizmit si në zemër, në tru, veshka etj.

Funksionimi normal i organeve të ORL-së lejon që hunda të jetë organ kryesor për frymëmarrjen (ajo të jetë gjithnjë e lirë), ku siç dimë afër pastrohet, lagështohet dhe mer temperaturën e trupit.

Rëndësi për organizmin ka edhe rritja e aftësisë mbrojtëse të tij me një regjim të drejtë pune, pushimi, higjienë, gjumë të mjaftueshëm si edhe ushqyerje e lumishme dhe e mjaftueshme me proteina, sheqerna,

nyndyrna e vitamina. Kalitja e organizmit të njeriut që në fëmijëri të hershme, imunitetit, me diellin, ajrin e ujin është më se i domosdoshëm. Vlen gjithashtu menjëherë i faktorëve të ftohjes, sepse nga ajo ndodhin prishje reflektore e qarkullimit të gjakut të organeve të ORL-së, duke ulur forcat mbrojtëse të organizmit dhe të krijimit të kushëve për mahisjen e tyre.

Për parandalimin e sëmundjeve të mesipërme rëndësi ka bashkëpunimi me otolaringologjinë, pediatrin, patologjinë, neurologun etj. Me rëndësi janë edhe depistimet në erdhje, kopshte, shkolla, reparte ushtarake, menjëherë apo izolimi i të sëmurëve, kur sëmundja tashmë është shkakuar si edhe dezinfektimi i shamive, enëve, lugeve dhe ndërsesave të të sëmurëve, respektimi i regullave higjienë - shëndetësore nga duart, goja, veshi si dhe gargaret e përsëritura

ra të grykës etj.

Kur sëmundja ka qenë e lehtë të paraqitet me shprehje të lehta. Rëndësi ka edhe gullimi i defekteve të tilla apo të situata të tilla si shtrembenimet e mësive, operimi i polipitumoreve dhe mjekimi i sëmundjeve të tilla si sinuzitit etj., me barna të mëlloshme dhe antibiotikë ndryshëm lokalë e gjënjekionale.

Në përfundim të kësaj teme të sëmundjeve të ORL-së duhet të ndalojmë hani, alkoolit, ushqyerjeve shumë të ngrohtëve, me i ftohtë, si edhe me pluhura të tepërta veshitërojnë frymëmarrjen. Mendojmë se këto këshilla të ndihmojnë sidomos ndërrit dhe fëmijët e rinj të tyre në këtë periudhë të ndryshimit të stinëve të cilat ka është mjaft delikate shëndetin.

YLLI KERCANI
otojater